



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 196, Datë 03.08.2022

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 154, DATË 13.06.2022
“MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË
KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË “ALBESP TRADING &
CONSULTING” SH.P.K.”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 03.08.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1379/4 prot., datë 26.07.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “*Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 154, datë 13.06.2022 “Mbi dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor që kontrollon interesat e “AlbEsp Trading & Consulting sh.p.k.”.*”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 154, datë 13.06.2022, vendosi dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. Në pikën 2 të këtij vendimi është përcaktuar se shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. duhet të njoftojë ERE-n për bërjen efektive të këtij transferimi, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi.
- ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendimmarrje me shkresën nr. 257/7 prot., datë 17.06.2022.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 257/8 prot., datë 12.07.2022, shoqëria ka depozituar ekstraktin historik të regjistrit tregtar të saj, ku janë reflektuar ndryshimet përkatëse, sikurse përcaktuar dhe në autorizimin e ERE-s.
- Me depozitim të këtij dokumenti rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 154, datë 13.06.2022.

- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shfuqizojë pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 154, datë 13.06.2022 “Mbi dhënien e autorizimit nga ere për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k.”.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI